



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZASTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE	
Jenka Org Dajg. Jashmisa Ag. Drit Z. Llapirova Z. N. Vlajnicë	Nr. Prot: Draj. Prot: Prot. No: Data: Datum: Date:
2363 01.06.17 Prishtina, Prishtina, Prishtina	

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZASTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

KONTRATA

Data e përgatitjes së kontratës:

01.06.2017

Nr. i Prokurimit ¹	209	17	011	236
-------------------------------	-----	----	-----	-----

Titulli: MBIKQYRJA E PROJEKTEVE

PJESA B: KONTRATA

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe "PMN"shpk dhe NPN"Univers-MI", Touk bashqe, ob.II, nr.1/6, Prishtinë dhe Avdullah Presheva, nr.37, Prishtinë (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për: Mbikqyrja e projekteve me numër Identifikues 209/17/011/236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: shërbimi pas-shitjes nga operatori ekonomik i shërbimeve te përshkruara ne Aneksin 1.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon me deri në përfundimin e projekteve për të cilat kontraktohet mbikqyrja e ndërtimit apo renovimit, gjegjësisht me fillimin e projektit - ndërtimit apo renovimit dhe me përfundimin e projektit - ndërtimit apo renovimit.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: ndërtimi i Qendrës për Aftësimë Profesionale në Podujevë, renovimi i Qendrës për Aftësimë Profesionale / Zyra e Punësimit në Prizren, renovimi i kulmit në Administratën Pensionale e Kosovës në Gjakovë, ndërtimi i objektit për Banim Social në lagjen Trepça në Stari Tërg, Mitrovicë apo projekt tjetër sipas nevojës.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: 2,312.80 €; (dymjë e treqind e dymbëdhjetë euro, tetëdhjetë cent) Euro.

3.2 Çmimi i përmendor në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Autoriteti Kontraktues do të paguaj se cilën shumë të detyrimeve pas pranimit të se cilës dërgesë.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për se cilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për tu dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njofojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi ti japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin ti realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon Kontrata

urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) la jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimeshi nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kérkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqip në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Zenun Tolaj	Emri:	Feti Ibishi
Pozita:	Drejtës	Pozita:	Udhëheqës Divizioni i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.06.2017	Data:	01.06.2017
Vula:		Vula:	

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Bardhok Jetishi
Pozita:	Drejtës
Nënshkrimi:	
Data:	01.06.2017
Vula:	

Kontrata

